



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2021:193200
Datë: 25.04.2024
Numri i dokumentit: 05622555

PA1.nr.336/24

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, Departamenti i Përgjithshëm – kolegji i përbërë nga gjyqtarët Abdullah Ahmeti - kryetar i kolegjit, Ferit Osmani dhe Mehmet Ndrecaj - anëtarë të kolegjit, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Rrezarta Bala, në çështjen penale ndaj të akuzuarit L. H., nga D, për shkak të veprës penale Kanosja, nga neni 181 par.2, të KPRK-së, duke vendosur sipas ankesës së të akuzuarit L. H., të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Pejë, P.nr.608/21, datë 14.12.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur, më datë 25.04.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e të akuzuarit L. H., ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Pejë P.nr.608/21, datë 14.12.2023, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Pejë, me aktgjykimin P.nr.608/21, datë 14.12.2023, të akuzuarin L. H. e ka shpallur fajtor, për shkak të veprës penale Kanosja, nga neni 181 par.2, të KPRK-së dhe e ka gjykuar me dënim me gjobë në shumë prej 1.000 (njëmijë) € e të cilin dënim i njëjti obligohet të paguaje në afat prej 3 (tre) muajsh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. Obligohet i akuzuari që dënimin e shqiptuar me gjobë si më lartë të paguaje në 2 (dy) këste të barabarta nga 500 (pesëqind) €, duke filluar nga data 01 e deri me datën 05 të çdo muaji vijues.

Mundësia e pagesës me këste, do të revokohet nëse i akuzuari nuk e paguan këstin me kohë. Nëse i akuzuari refuzon, dështon apo nuk paguan dënimin e shqiptuar me gjobë si në piken I të dispozitivit të këtij aktgjykimi në afatin e caktuar i njëjti do të zëvendësohet me dënim burgimi duke i llogaritur shumen prej 20 (njëzetë) €, për 1 (një) ditë burgimi. Nëse i njëjti nuk dëshiron ose nuk mund të paguaje gjobën në tërësi, gjykata do ta zëvendësoje pjesën e mbetur të gjobës me burgim. Nëse i njëjti e paguan pjesën e mbetur të gjobës, ekzekutimi i dënimit me burgim ndërpritet. Është obliguar i akuzuari që gjykatës ti paguan shpenzimet e procedurës penale dhe paushallin gjyqësor në shumë prej 30 (tridhjetë) € dhe shumën prej 20 (njëzetë) €, në emër të fondit për kompensimin e viktimave të krimit. I dëmtuari, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt civil.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ankesë ka paraqitur :

I akuzuari L. H., për shkak të vendimit lidhur me sanksionin penal, duke i propozuar Gjykatës së Apelit të Kosovës, ankesa të aprovohet në tërësi si e bazuar, aktgjykimin e ankimuar të e ndryshoj dhe të akuzuarit të i shqiptoj dënim më të butë me gjobë apo të njëjtit të i shqiptoj vërejtje gjyqësore.

Prokuroria e Apelit e Kosovës, me parashtrësën PPA/II.nr.346/2024, të datës 06.03.2024, ka propozuar që të refuzohet si e pa bazuar ankesa e të akuzuarit, ndërsa aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë të vërtetohet.

Kolegji penal i Gjykatës së Apelit të Kosovës, pasi mbajti seancën e kolegjit, shqyrtoj shkresat e lëndës, vlerësoj pretendimet ankimore dhe analizoj aktgjykimin e ankimuar në kuptim të nenit 394 paragrafi 1 të Kodit të Procedurës Penale (KPP), konstatoj se :

- Ankesa është e pabazuar.

Edhe pse aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë nuk është ankimuar për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkeljeve të ligjit penal, megjithatë kolegji penal i Gjykatës së Apelit të Kosovës, duke u bazuar në nenin 394 paragrafi 1 të KPP, sipas detyrës zyrtare e shqyrtoj aktgjykimin e ankimuar edhe në këto drejtime dhe konstatoj se aktgjykimi i ankimuar nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale e as shkelje të ligjit penal në dëm të të akuzuarit, të cilat do e kishin e kushtëzuar anulimin e tij.

Po ashtu as gjendja faktike nuk ka qenë objekt vlerësimi i kësaj gjykate, ngase në ankesë nuk ka mundur të kontestohet, sepse i akuzuari në shqyrtimin gjyqësor e ka pranuar fajësinë për të gjitha pikat e akuzës, edhe gjykata është pajtuar me një pohim të tillë, prandaj sipas nenit 383 par. 2 të KPPK-së, ndaj aktgjykimit që është marrë në bazë të pranimin të fajësisë ose marrëveshjes për pranimin e fajësisë nuk lejohet ankesa për gjendjen faktike, andaj aktgjykimi i ankimuar u vlerësua vetëm në frymën e pretendimeve ankimore sa i përket vendimit për dënim.

I akuzuari L. H. e ankimon aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë sa i përket vendimit lidhur me sanksionin penal duke pretenduar që konsiderojmë se dënimi i shqiptuar është shumë i lartë, pasi që dihet se i akuzuari e ka pranuar fajësinë, e ka gjendjen e dobët ekonomike, premtimin se në të ardhmen nuk do të kryej vepra të tilla penale apo të ngjashme. Gjykata gjatë

arsyetimit të rrethanave rënduese mori të kaluarën kriminale dhe faktin se i njëjti ishte i dënuar edhe më herët për vepra penale, mirëpo i akuzuari këto vepra i ka kryer në moshë të re, i pa vetëdijshëm, për pasojat dhe veprimet të tij dhe pas ekzekutimit të dënimeve për këto vepra i njëjti është risocializuar mjaftë mirë në shoqëri, ka filluar që të punoj të përkujdeset për familjen 5 anëtarëshe, të cilën mbijetesën e sigurojnë në punë sezonale, prandaj konsiderojmë që kanë qenë bazë e mjaftueshme që ndaj të njëjtit të shqiptohet dënim me gjobë nën minimum. I njëjti aktualisht punon disa punë krahu, andaj edhe këtë lartësi të dënimit prej 1.000 € i rrezikohet ekzistenca e tij e posaçërisht e familjes së tij edhe ashtu me mjaftë probleme shëndetësore. I propozon Gjykatës së Apelit të Kosovës, ankesa të aprovohet në tërësi si e bazuar, aktgjykimin e ankimuar të e ndryshoj dhe të akuzuarit të i shqiptoj dënim më të butë me gjobë apo të njëjtit të i shqiptoj vërejtje gjyqësore.

Sipas vlerësimit të kolegjit penal të Gjykatës së Apelit të Kosovës, pretendimet ankimore të paraqitura në ankesën e të akuzuarit, për shqiptimin e një dënimi më të butë ose shqiptimin e vërejtjes gjyqësore, ndaj të akuzuarit, janë të pabazuara. Kjo për faktin se gjykata e shkallës së parë në përgjithësi drejtë i ka konstatuar dhe vlerësuar rrethanat të cilat ndikojnë në caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit, ndërsa në ankesën e lartcekur nuk është paraqitur ndonjë rrethanë e rëndësishme dhe e posaçme që nuk është vlerësuar nga gjykata e shkallës së parë, e cila do ta arsyetonte shqiptimin e një dënimi më të butë ose shqiptimin e vërejtjes gjyqësore, ndaj të akuzuarit. Kështu, gjykata e shkallës së parë me rastin e matjes së dënimit ndaj të akuzuarit e duke u bazuar konform të dispozitës së nenit 69 dhe 70 të KPRK-së gjykata si rrethana lehtësuese gjeti se i akuzuari e ka pranuar fajësinë në shqyrtimin fillestar, si dhe faktin së me palën e dëmtuar i ka përmirësuar raportet, ndërkaq nga rrethanat rënduese gjykata në rastin konkret gjeti së i akuzuari edhe më parë ka qenë i dënuar dhe kjo vërtetohet me Aktgjykimet e siguruara përmes Sistemit për Menaxhimin Informativ të Lëndëve, ku i njëjti rezulton së është dënuar me Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Pejë nën shenjen P.nr. 720/17 dt. 14.12.2018 si dhe me Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Gjakovë nën shenjen P.nr.308/22 dt. 09.11.2022, po ashtu gjeti shkallen e lartë të dashjes në kryerjen e veprës penale pasi që i akuzuari edhe pasi që e ka kërcënuar një herë të dëmtuarin i cili ka filluar të ikë nga lokali ku janë takuar, i akuzuari e ka ndjekur duke e kanosur përsëri me fjalët e përsëritura si në dispozitiv, e po ashtu gjeti edhe sjelljen arrogante në gjykatë në seancën e shqyrtimit fillestar ku i njëjti me rastin e prezantimit të tij e ka hedhur letërnjoftimin e tij në tavolinën e gjyqtarës. Andaj, duke i pasur parasysh të gjitha rrethanat e lartcekura gjykata e shkallës së parë i shqiptoi të akuzuarit dënimin sikurse në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar me bindjen se edhe me një dënim të tillë do arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me dispozitën e nenit 38 të KPRK-së. Një vlerësim të këtillë të rrethanave relevante për matjen e dënimit si të drejtë dhe të ligjshëm e pranon edhe kjo gjykatë dhe gjen se gjykata e shkallës së parë drejtë dhe në mënyrë të plotë i ka vlerësuar rrethanat të cilat ndikojnë në caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit, ndërsa rrethanat e pretenduara lehtësuese në ankesën e të akuzuarit, sipas vlerësimit të kësaj gjykate nuk janë të atij karakteri dhe nuk kanë ndikim që të akuzuarit t'i shqiptohet një dënim tjetër nga ai të cilin e ka shqiptuar gjykata e shkallës së parë apo që akuzuarin të i shqiptoj një dënim më të butë ose shqiptoj vërejtje gjyqësore, sikurse që pretendohet në ankesë, të gjitha këto rrethana sipas vlerësimit të kolegjit penal të kësaj gjykate japin bazë të mjaftueshme që arsyetojnë shqiptimin e dënimit nga gjykata e shkallës së parë si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar, andaj duke marrë parasysh

rrethanat e konstatuara dhe drejtë të vlerësuara nga ana e gjykatës së shkallës së parë, del se dënimi i shqiptuar ndaj të akuzuarit është në harmoni me intensitetin e rrezikshmërisë shoqërore të veprës së kryer penale, me shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit si ekzekutorë dhe se kjo do t'i shërbej preventivës gjenerale, posaçërisht asaj individuale, forcimit të moralit të shoqërisë, si dhe përgjegjësisë dhe disiplinës së qytetarëve, se me këtë kryerësi do të parandalohet nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, si dhe do të bëhet rehabilitimi i tij. Andaj kolegji penal i kësaj gjykate konsideron se dënimi i shqiptuar është i mjaftueshëm për tu arritur qëllimi i dënimit i paraparë me dispozitën e nenit 38 të KPRK-së.

Duke u bazuar në këto që u cekën më lart dhe në bazë të nenit 401 të KPP, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
Departamenti i Përgjithshëm
PA1.nr.336/24, më datë 25.04.2024

Zyrtarja ligjore;
Rrezarta Bala

Kryetari i kolegjit
Abdullah Ahmeti

Anëtarët e kolegjit:
Ferit Osmani

Mehmet Ndrecaj